



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 04

Datë: 22. 02. 2017. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Eshref Vishi, Binak Vishaj, Bajram Ljatifi, Ercan Spat dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP). Përkthyesë: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

2. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- **Këshilli i Personelit;**

- *Rekomandimi për kërkesën e drejtorit të prokurimit, për angazhim të stafit shtesë, për shkak të aktiviteteve të shumta në punë;*
- *Rekomandimi për kërkesën e Koordinatorit të Terrenit;*

3. Të ndryshme

1. Hyrje

Valdete Daka: Në rend dite i kemi dy pika, prej të cilave një ra i ka dy pika....! Mirë, kush është për kë të rend dite..?

Adnan Rrustemi: Kam një vërejtje, sado që proceduarisht nuk jam kundër, po ka një lajthitje të procedurës të përpilimit të k'tyre temave. Nuk e di a është bërë me qëllim, a pa qëllim po, unë jam kundër që KQZ të trajtoj kërkesa specifike që vijnë prej një sive, cilat do qofshin ato, që vijnë direkt në KQZ. KQZ, duhet t'i trajtoj kërkesat që vijnë nga Krye shefi, dhe jo nga punëtorët. Mund të kuptohet si ndërhyrje në Sekretariat, por nuk mund të vijnë kërkesa përtej kryeshefit...

Valdete Daka: Plotësisht pajtohem, sepse kërkesat që vijnë tek ne si kërkesa të Krye shefit.

Ilir Gashi: Ne, në KP e kemi trajtuar këtë çështje. Pra, në Këshill të Personelit ne e kemi trajtuar si kërkesë që ka ardhur nga krye shefi. E kemi trajtuar edhe kë të çështje, pra kemi qenë pro, e kemi dhënë mendimin pozitiv si kërkesë .

Eshref Vishi: Nuk ka asgjë personale, ka procedurale, këtu është problemi...! Se, nuk mund të formohet asnjë organ dhe as të anulohet asnjë organ brenda strukturës organizative me vendime të ndryshme. Ne kemi një rregullore: aty debatojmë çka duhet me ndryshuar, dhe çka duhet me heqë ...

Ercan Spat: Mbasi që po hyjmë në detale, kryetare është rendi te ju: Ju, kryetare ftesën për kë të mbledhje e keni thirr në kundërshtim me rregulloren, sepse mbledhja thirret 48 orë përpara. Shkelja e parë , e dyta, pika e parë e cila po propozohet, unë jam kundër saj dhe nuk do të votoj sot, sepse ka implikime buxhetore. Kë to pika, të kë tilla, së pari duhet të trajtohen në kë shillin e buxhetit.

Sami Hamiti: Ajo që e tha Adnani, ka të drejtë sepse, kërkesat për pikë n e parë për dy punëtorë t e Prokurimit, edhe në pjesën tjetër duhet të jetë nga Kryeshefi për KQZ-në . Në atë moment që vjen prej krye shefit, ai e din edhe pjesën buxhetore dhe, hezitim ne nuk do të kishim! Kryeshefi, mbasi që aprovohet në këshill, duhet të vjen nga Kryeshefi për KQZ-në . Plus, teksti është katastrofalisht në shqip i shkruar, i ka tana gabimet...

Adnan Rrustemi: Kjo nënkupton, m'u heqë nënpika dy. Unë , nuk e kisha të qartë se, a ishte kërkesë e këshillave apo e kryeshefit...

Betim Gjoshi: Ne, ashtë mirë me pas standarde për secilën n mbledhje. Për aspekte procedurale, ne mund të gabojmë shpesh! Kurse, çështjet që tangojnë njëra tjetrën duhet diskutuar por, po e shoh që, te pika e dytë, nuk po kërkohet miratim. Pajtohem që

proceduralisht, kërkesa të kishte edhe një akt përcjellës, por kemi pas praktika të këtilla. Po votoj, por ta shohim përmbajtjen. Nëse përmbajtja nuk është në rregull, nuk e votojmë ...

Binak Vishaj: Fatkeqësisht, nuk e kemi proceverbalin e këshillit... Sikur ta kishim procesverbalin, krejt këto çështje që po thuhet, do të ishin të zgjidhura. Ne, kemi thënë që ky material, të vij në KQZ. Sot, ne duhet të vendosim se, a do të trajtohet në punëtori! Është rekomandim i këshillit, është kërkesë e kryeshefit e dërguar në këshill, dhe këshilli, e ka sjellë në KQZ...

Ne, vetë kemi thënë që aktivitetet e prokurimit, me i ba në pjesën e parë të vitit...

Adnan Rrustemi: Kur procedura e përcakton përmbajtjen, unë jam të ndalemi te procedura. Problemi im, është, se: Kërkesat kur bë het fjalë për stafin, kërkesat e secilës njësi, përfundojnë te kryeshefi. Edhe formën e ndërrojnë nga kryeshefi, unë dua ta kemi kërkesën, bile edhe vlerësimin nga kryeshefit... Kryeshefi, e ka bërë kërkesën vetëm për këshill...Dhe, nuk është praktikë që ne të marrim vendim se cilën çështje me e futë në punëtori...! Le të del propozim atje...

Illir Gashi: Unë , thash: Kjo çështje, unë pajtohem që nuk është dashur me ardhë këtu, por KP e ka pranuar si kërkesë ...që, të jetë pjesë e diskutimeve për gjithë organizimin tjetër të brendshëm të Sekretariati. Pika e dytë : pra, unë po flas për kë të pikë, se jemi pajtuar edhe me shkresën si këshill, jemi pajtuar edhe me shkresën...dhe, ne e shohim se, a pajtohemi apo jo...!

Valdete Daka: A e votojmë rendin e ditës...? Kush është për këtë rend dite...? Kurse, propozimi është që të hiqet nënpika e dytë...

Anëtarët e KQZ-së, votuan heqjen e nënpikës së dytë nga rendi i ditës (kundër: Betim Gjoshi, Binak Vishaj, Bajram Ljatifi, Ercan Spat), me qëllim që e njëjta, të diskutohet në punëtori. Pastaj, anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës (kundër: Ercan Spat).

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli i Personelit

Bajram Ljatifi: Këshilli i Personelit, në mbledhjen e fundit, vendosi që të miratohet kërkesa për angazhimin e dy zyrtarëve me kontratë mbi vepër në kohë të caktuar prej tre muaj, me mundësi vazhdimi. Ne, kemi shqyrtuar kërkesën, dhe i rekomandojmë KQZ -së për miratim.

Betim Gjoshi: Ne, diskutuam në se kjo, është apo s'është kërkesë e Kryeshefit...

Enis Halim: Unë, e kam miratuar kërkesë n e drejtorit të Prokurimit, sepse konsideroj që është një kërkesë e bazuar...Edhe pse ende nuk jemi në periudhë zgjedhore, jemi në vit zgjedhor. Duke konsideruar që më herë t'i përfundojmë procedurat e prokurimit, angazhimi i këtyre zyrtarëve është i nevojshëm tash, na mundëson që ne t'i kemi veç të përfunduara obligimet që i kemi sipas planit të prokurimit para se të hyjmë në proces zgjedhor. Nuk ka ndonjë pengesë ...

Adnan Rrustemi: Unë, nuk kam informacion se, a i ka miratuar kërkesat kryeshefi apo jo...! Por, për KQZ ekziston kryeshefi, sekretariati dhe zyra e partive. Asnjë pozicion tjetër, nuk përmendet në ligj. Neve, duhet të na vijë vlerësimi i kryeshefit..., prandaj kjo le të vlejë edhe për stafin tjetër, pra ai, le t'i qesë ai në KQZ. Tjetra: një konkurs, para një jave, e kam parë në hyrje të KQZ. Në se konkursi është për një pozitë të këtillë, për mua është absurd që po vendosim sot, dhe e dyta, dy zyrtar...a, janë veç për tre muaj, apo edhe për më vonë ...?

Enis Halimi: Tre muaj të angazhohen fillimisht, dhe pastaj varësisht nga dinamika...Sa i përket konkursit, ka pas shkarje në procedura dhe unë menjë herë , sapo kam kuptuar e kam anuluar konkursin...

Eshref Vishi: është mirë që kryeshefi, t'i konvertoj të gjitha shkresat që vijnë për këshill, një, dhe dy, parimisht, unë do kisha një qasje tjetër sepse, ne nuk jemi në zgjedhje. Kemi mjaft zyrtar nga KKZ-së që nuk bëjnë asgjë, rrinë deri në shpalljen e zgjedhjeve. Angazhimi i tyre, meqë ka juristë dhe financierë që i kuptojnë mjaft mirë këto detyra, dhe ata mund të angazhohen...

Sa i përket konkursit, kushteve, nuk pajtohem me pikën dy: "Përvojë pune në prokurim!". Duhet të jetë : sa është ajo përvojë , dhe në cilat institucione është ajo përvojë, dhe nën 6: "Njohuria e punës në përvojën e prokurimit, është e dëshirueshme...!". Nuk është e dëshirueshme, duhet të jetë obligative. Nuk na duhen njerëz që vijnë dhe marrin përvojë në KQZ, por njerëz që japin kontribut në punë në KQZ...

Sami Hamiti: Duhet të kihet kujdes në këto procedura, shumë bile...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e Këshillit për Personel me 7 vota për, me 2 abstenime, dhe 1 kundërshtim.

3. **Tw ndryshme**

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
